



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.181/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Zenel Leku dhe Rustem Thaqi, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit R.D. nga Gj., të cilin e përfaqëson me autorizim avokati Teki Bokshi nga Gj., kundër të paditurve Xh. D. nga Gj., të cilin e përfaqëson avokati Rexhep Gjokolli nga Gj., E. D. dhe G. D. nga Gj., për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, duke vendosur sipas revizionit të paditurit të parë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1205/20 datë 22.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i të paditurit Xh. D. nga Gj., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1205/20 dt. 22.01.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1205/20 datë 22.01.2024, është refuzuar si e pathemeltë ankesa e të paditurit të parë Xh. D. nga Gj., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.343/17 i datës 10.12.2019, është vërtetuar, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe vërtetohet se paditësi është pronarë në ¼ pjesë ideale të ngastrës kadastrale ... ZK-Gj., jashtë qytet,

me kulturë jo pjellore, me objekt shtëpi B+P+1+ NDK, në sipërfaqe prej 153 m², kuzhinë verore 52 m² dhe oborr në sipërfaqe prej 185 m², në sipërfaqe të përgjithshme prej 339 m², e cila kufizohet në veri në gjatësi prej 30 m me ngastrën kadastra ... nr... ZK-Gj., jashtë qytet, në anën lindore në gjatësi prej 13 m, me ngastrën kadastrale ..., ZK-Gj., jashtë qytet, në anën jugore në gjatësi prej 30 m, me ngastrën kadastra ... nr... ZK-Gj., jashtë qytet, dhe në anën perëndimore në gjatësi prej 13 m, me rrugë publike ZK-Gj., jashtë qytet, ashtu që detyrohen të paditurit, që paditësit të ia pranojnë këtë të drejtë dhe të lejojnë që kjo paluajtshmëri në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Gjakovë, të regjistrohet në emër të paditësit, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën ky aktgjykim do të shërbejë si titull ekzekutiv për regjistrim. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, detyrohen të paditurit, që paditësit, në emër të shpenzimeve procedurale, në mënyrë solidarë të ia paguajnë shumën prej 1.589,60 euro, në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në afat ligjor i padituri i parë, ka paraqitur revizion për shkak të, siç thuhet në të, shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që ankesa e të paditurit të parë, e paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë të miratohet dhe të ndryshohet ashtu që padia e paditësit, sa i përket të paditurit të parë të refuzohet në tërësi si e pa bazuar ose aktgjykimet, si ai i shkallës së dytë dhe ai i shkallës së parë, lidhur me pjesën që ka të bëjë me të paditurin e parë, të prishen dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe në rivendosje.

Përgjigje në revizion ka paraqitur pala paditëse, nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që i njëjti të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së, si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i të paditurit të parë Xh. D., nga Gj., është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi më datën 23.06.2017, në gjykatën e shkallës së parë, kanë ngritur padi kundër të paditurve, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se është pronar në 1/4 të paluajtshmërisë me të dhënat si në petitumin e padisë, përkatësisht, si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Nga deklaratat e dhëna të paditurve E. D. dhe G. D., të vërtetuara nga Noteri Sh. V., më dt.15.06.2017, është theksuar se paluajtshmëria është blerë bashkërisht nga të gjithë familjarët para shumë viteve dhe kemi pas ndërtuar shtëpi dykatëshe ku edhe kemi jetuar. Mirëpo, e njëjta shtëpi është djegur gjatë kohës së luftës së vitit 1999 dhe në vitin 2001, e kemi ndërtuar shtëpinë e banimit dhe atë në tre kate. Të hollat për ndërtimin e asaj shtëpie në paluajtshmërinë e lartë cekur i ka dërguar nga Gjermania ku ishte i punësuar vëllai R. D., (këtu paditësi) dhe se shtëpinë e ndërtuar tërësisht me kontributin e tij. Tani në këtë shtëpi jetojmë dhe banojmë ne, vëllai tjetër Xh., dhe se nuk ia kontestojmë pronësinë në atë paluajtshmëri vëllait R. D., i cili duhet të jetë pronarë i ¼ pjesë ideale të paluajtshmërisë së cekur më lartë, si gjithë ne të tjerët edhe pse ka kontribuar më tepër se ne.

Nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë (që gjendet në shkresat e lëndës) dhe nga Certifikata mbi të drejtat pronësore, lidhur me ngastrën kadastrale ..., të lëshuar nga DGJK më dt.25.06.2014, del se paluajtshmëria e sipër cekur, është pronë private me sipërfaqe prej 390 m², tokë jo pjellore, ndërsa, si bashkë posedues paraqiten G. D., E. D., dhe Xh. D., me nga 1/3, me masat dhe kufi si në ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë, ndërkohë që, nga ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë (që po ashtu gjendet në shkresat e lëndës), rrjedh se, në total, parcela e sipër cekur, së bashku me objektet e sipër përmendura në të, është në vlerë të përgjithshme prej 171.663.00 euro.

Nga kontrata e shitblerjes e legalizuar në gjykatë me nr.Vr.nr..., vërtetohet se më dt.12.09.1968, H. G., nga Gj., iu ka shitur parcelën nr..., të paditurve. Nga provat tjera – transaksionet bankare, që gjenden në shkresat e lëndës, e që janë drejtuar në emër të F. D., I. D., E. D., Xh. D., (nënës, babait, vëllezërve të paditësit), etj, del se paditësi nga Gjermania, ka dërguar mjete - të holla të lartë përmendurve. Nga Draft Certifikata mbi të drejtat pronësore të lëshuar nga DGJK dt.3.07.2019, vërtetohet se paditësi është

posedues i ngastrës kadastrale nr..., në sipërfaqe prej 312 m², posedues në 1/1, duhet shtuar se parcela në fjalë nuk është objekt i këtij kontesti.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar edhe prova tjera, si dëgjimin e palëve ndërgjyqësore, nga rezulton, veç tjerash, se babai i tyre, I. D., gjatë v.1967, e ka blerë paluajtshmërinë kontestuese nga H. G. nga Gj., pastaj, në shtëpinë e ndërtuar në të, në atë bashkësi familjare, kanë jetuar e banuar të gjithë së bashku, (paditësi dhe të paditurit, pra, janë vëllezër dhe motër), ashtu që e njëjta, gjatë luftës, në vitin 1999, është djegur tërësisht, dhe më pas, sikundër kanë deklaruar edhe vet të paditurit, për rindërtimin e shtëpisë, paditësi i cili punonte në Gjermani (nga v. 1969), u ka dërguar të holla për shpenzimet e ushqimit dhe për ndërtimin e shtëpisë, si dhe e njëjta është rindërtuar menjëherë pas përfundimit të luftës dhe të cilën e shfrytëzojnë bashkërisht.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave dhe në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndaj, në bazë të nenit 23 etj, të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, ka vendosur si në pjesën I dhe II, të dispozitivit të aktgjyqimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se e njëjta, drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka vendosur si në dispozitivin e aktgjyqimit të saj.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjyqimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje të së drejtës materiale. Dispozitivi i aktgjyqimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë dhënë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit për shkelje të dispozitave të LPK-së dhe shkelje të së drejtës materiale, nuk mund t'i vënë në pyetje aktgjyqimet e instancave më të ulëta.

Gjykata Supreme e Kosovës, e konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instancës më të ulët, përkitazi me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit pasi që janë dhënë arsyet ligjore bindëse dhe të pranueshme edhe nga kjo gjykatë. Prandaj, edhe Gjykata Supreme e Kosovës, përkitazi me rastin konkret civil juridik, vlerëson se miratimi i tillë i kërkesëpadisë së paditësit është i drejtë, me që, veç tjerash, paraprakisht, nga provat e administruara, është vërtetuar se paditësi dhe të paditurit, së bashku edhe me paraardhësin e tyre, të atin, tani të ndjerin I. D., ish nga Gj., (i cili ka blerë paluajtshmërinë kontestuese në v.1967, nga H. G. nga Gj.), kanë jetuar e banuar së bashku në bashkësi familjare, në shtëpinë e ndërtuar në atë paluajtshmëri, e cila më pas, gjatë luftës në Kosovë (1999), ishte djegur në tërësi, ndërsa, më pas, ishte rindërtuar shtëpia e re, në tre kate, në të cilën banojnë dhe të njëjtën e shfrytëzojnë së bashku. Për rindërtimin e të njëjtës, sikundër është provuar, nga provat e administruara, veç tjerash, edhe nga deklarimi e dëgjimi i vet palëve ndërgjyqëse, ka kontribuar në masë të madhe, edhe vet paditësi, i cili punonte në Gjermani nga viti 1969 dhe që u kishte dërguar të holla familjarëve të tij, për shpenzimet e jetesës dhe rindërtimit të shtëpisë.

Kështu, duhet theksuar se me nenin 271 të Ligjit për Familjen i Kosovës, parashihet se ” Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve, personat e tjerë të afërm të familjes dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji ”. Kurse, me nenin 272, të njëjtit ligj, parashihet se “ Tërë pasuria e fituar gjatë kohëzgjatjes së këtij bashkimi konsiderohet të jetë pasuri e përbashkët e të gjithë anëtarëve të cilët kanë marrë pjesë në fitimin e saj ”.

Në kontekstin e mësipërm, duhet marrë parasysh edhe nenin 20 dhe 21 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, ku veç tjerash, parashihet se e drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit, në bazë të punës juridike dhe me trashëgimi..., sipas vet ligjit, e drejta e pronësisë fitohet me krijimin e sendit të ri, me bashkimin, përzierjen, ndërtimin në tokën e huaj, me parashkrim fitues (usucapio), fitimin e pronësisë nga jo pronari, dhe në rastet tjera të parapara me ligj, sikundër është edhe rasti konkret civil – juridik, nga i cili, pas administrimit të provave, rezulton bindshëm themelësia e kërkesëpadisë së paditësit. Ndërkohë që, përkitazi me këtë që u

sipër theksua, me dispozitën e nenit 253.2 të LPK-së, parashihet se “ Gjykata nuk është e lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë ”, prandaj, nga këtu, edhe pretendimet e revizionit për shkelje të së drejtës materiale dhe procedurale, janë të pa bazuara dhe si të tilla nuk qëndrojnë.

Për arsyet e sipërpërmendura, revizioni i të paditurit të parë u refuzua si i pa themeltë, andaj, sipas dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.181/2024 datë 30.04.2024

Kryetari kolegjit

Mr.sc.Muhamet Rexha